

Gjykata Supreme e Kosovës  
23 gusht 2011  
Pkl-Zz 91/10

## NË EMIËR TË POPULLIT

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**, në kolegjin e përbërë prej gjyqtarit të EULEX-it Lars Dahlstedt si Kryetar kolegji dhe gjyqtarit të EULEX-it Francesco Florit, gjyqtaret e Gjykatës Supreme Marije Ademi, Emine Mustafa dhe Gyltene Sylejmani si anëtare të kolegjit, me asistimin e Zyrtares Ligjore Chiara Rojek si procesmbajtëse,

Në lëndën kundër të pandehurit P. [REDAKTUE] G. [REDAKTUE]  
[REDAKTUE] me shtetësi serbe, adresa e fundit e njojur e banimit [REDAKTUE] Republika e Serbisë, i pamartuar, me shkollim tre (3) vjeçar profesional, i papunësuar,

I dënuar në shkallën e parë me aktgjykimin P. Nr. 134/08 të Gjykatës së Qarkut të Mitrovicës më datën 19 nëntor 2009, për veprat penale Nxitja e urrejtjes, e përçarjes ose e mos durimit kombëtar, racor, fetar a etnik në kundërshtim të nenit 115 paragrafi 1 i Kodit Penal të Kosovës (KPK) (Pika A), dhe Vrasje e Rëndë në Tentativë në kundërshtim të nenit 147 pika 10 e KPK në lidhje me nenin 20 paragrafi 1 i KPK (Pika B), dhe i dënuar me një dënim unik prej gjashtë (6) vjet dhë tre (3) muaj sipas nenit 71 paragrafi 1 dhe 2 pika 2 të KPK,

Më tej i dënuar në shkallën e dytë me dympëdhjetë (12) vjet burgim për Pikën B dhe me një dënim unik prej dympëdhjetë (12) vjet e tre (3) muaj me aktgjykimin Ap - Kž. Nr. 24/2010 të Gjykatës Supreme të Kosovës të datës 4 maj 2010,

Duke vepruar sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të paraqitur nga avokatët mbrojtës L. [REDAKTUE] P. [REDAKTUE] dhe M. [REDAKTUE] B. [REDAKTUE] në emër të pandehurit P. G. [REDAKTUE] të paraqitur më 1 shtator 2010 kundër aktgjykimit të shkallës së dytë Ap - Kž. Nr. 24/2010 të Gjykatës Supreme të Kosovës të datës 4 maj 2010, dhë përgjigjes së Zyrës të Prokurorit të Shtetit të Republikës së Kosovës (ZPSHk) në kërkesën e të pandehurit për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur më 9 shkurt 2011,

Pas këshillimit më 12 dhe 19 korrëk si edhe më 23 gusht 2011, në pajtim me nenet 454 paragrafi 1 dhe 456 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), lëshon këtë:

### AKTGJYKIMI

- Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e paraqitur nga avokatët mbrojtës L. [REDAKTUE] dhe M. [REDAKTUE] B. [REDAKTUE] në emër të pandehurit P. G. [REDAKTUE] të shtator 2010 është paraqitur në kohë në pajtim me nenin 452 paragrafi 1 të KPPK.
- Kërkesa e përmendur për mbrojtjen e ligjshmërisë përmes kësaj REPUZQHET



## ARSYETIM

### I. Historia e procedurës

Më 12 dhjetor 2008, është paraqitur aktakuzë kundër P. [REDAKTUE] G. [REDAKTUE] për veprat penale Nxitja e urrejties, e përcarjes ose e mos durimit kombëtar, racor, fetar a etnik në kundërshtim të nenit 115 paragrafi 3 të lexuar me paragrafin 1 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK) dhe Terrorizëm në kundërshtim të nenit 109 paragrafi 1 pikat 1, 7 dhe 10 të KPPK.

Lënda është marrë nga Zyra e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK) më 16 prill 2009. Më 2 korrik 2009, PSRK paraqiti një aktakuzë të ndryshuar duke akuzuar të pandehurin edhe për veprën penale Vrasje e Rëndë në Tentativë dhe të konfirmuar nga Gjykata e Qarkut të Mitrovicës me aktvendimin e datës 6 korrik 2009.

Shqyrtim gjyqësor është mbajtur në mes të 27 korrik dhe 19 nëntor 2009. Akuza për Kryerje të Terrorizmit ishte refuzuar sipas nenit 389 pika 1 e KPPK. Më 19 nëntor 2009, Gjykata e Qarkut të Mitrovicës shpalli të pandehurin fajtor për veprat penale Nxitja e urrejties, e përcarjes ose e mos durimit kombëtar, racor, fetar a etnik në kundërshtim të nenit 115 paragrafi 1 i KPK dhe Vrasje e Rëndë në Tentativë në kundërshtim të nenit 147 pika 10 e KPK në lidhje me nenin 20 paragrafi 1 i KPK. Dënimet e veçuara prej gjashtë (6) muaj për veprën penale Nxitja e urrejties, e përcarjes ose e mos durimit kombëtar, racor, fetar a etnik dha gjashtë (6) vjet për veprën penale Vrasje e Rëndë në Tentativë u shqiptuan kundër të pandehurit. Gjykata, duke marrë parasysh se rrëthanat lehtësuese i peshoj më shumë se rrëthanat rënduese dhe, bazuar në nenet 66 dhe 67 të KPK, shqiptoi një dënim më të vogël se minimumi i parashikuar nga ligji ndaj të pandehurit prej gjashtë (6) vjet dhe tre (3) muaj sipas nenit 71 paragrafët 1 dhe 2 pika 2 të KPK-së. Të njëjtën ditë Gjykata e Qarkut të Mitrovicës lëshoi aktvendimin duke shqiptuar paraburgimin ndaj të pandehurit derisa aktgjykimi të merrte formën e prerë.

Më 11 janar 2010 avokatët mbrojtës L. [REDAKTUE] P. [REDAKTUE] dhe M. [REDAKTUE] B. [REDAKTUE] në emër të pandehurit P. [REDAKTUE] G. [REDAKTUE] paraqiten ankesë kundër aktgjykimit. Më 27 janar 2010 E. [REDAKTUE] P. [REDAKTUE] dhe A. [REDAKTUE] X. [REDAKTUE] si palë të dërmuara paraqiten ankesë kundër aktgjykimit. ZPSK paraqiti mendimin për të dy ankesat kundër aktgjykimit të kundërshtuar në Gjykatën Supreme të Kosovës më 30 mars 2010.

Më 4 maj 2010, Gjykata Supreme e Kosovës, me aktgjykimin AP-Kž. Nr. 24/2010, refuzoi ankesën e paraqitur nga avokatët mbrojtës L. [REDAKTUE] P. [REDAKTUE] dhe M. [REDAKTUE] B. [REDAKTUE] për të pandehurin dhe hodhi poshtë ankesën e paraqitur nga pala e dëmtuar A. [REDAKTUE] X. [REDAKTUE] Gjykata pranoi ankesën e palës së dëmtuar E. [REDAKTUE] P. [REDAKTUE] dhe pjesërisht modifikoi aktgjykimin e shkallës së parë duke e dënuar të akuzuarin me dymbëdhjetë (12) vjet burgim për Pikën B, kështu me një dënim unik prej dymbëdhjetë (12) vjet e tre (3) muaj.

Avokatët mbrojtës paraqiten kërkosë për mbrojtjen e ligjshmërisë në emër të F. [REDAKTUE] Gjorgjeviq më 1 shtator 2010. Më 9 shkurt 2011 ZPSK paraqiti përgjigje në kërkosën e tij të pandehurit për mbrojtje të ligjshmërisë. Më 7 korrik 2011, avokatët mbrojtës paraqiten



në Gjykatën Supreme një parashtresë shtesë. Të njëjtën ditë ajo i është komunikuar ZPSK-së.

## *II. Çështjet e ngritura në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe përgjigje*

Avokatët mbrojtës pretendojnë se aktgjykimi i shkallës së dytë i Gjykatës Supreme të Kosovës i datës 4 mars 2010 përmban:

- Shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të parashikuar nga neni 403 paragrafi 2 i KPPK të lexuar me nenin 400 paragrafet 1, 2 dhe 4 dhe neni 404 pika 5 e KPPK;
- Shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të parashikuar nga neni 403 paragrafi 1 pika 12 e KPPK; dhe
- Shkelje e ligjit penal.

Prandaj ata propozojnë që aktgjykimi i shkallës së dytë të ndryshohet duke zbatuar nenin 457 paragrafi 1 pika 1 e KPPK dhe që ankesa e palës së dëmtuar E [REDACTED] P [REDACTED] të deklarohet e papranueshme ose në mënyrë alternative, që Gjykata Supreme të anuloj aktgjykimin e kundërshtuar dhe të kthej lëndën prapa në shkallën e dytë.

*1. Shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale të parashikuar nga neni 403 paragrafi 2 pika 1 e KPPK të lexuar me nenin 400 paragrafi 1, 2 dhe 4 si edhe neni 404, pika 5 e KPPK*

Avokatët mbrojtjes pretendojnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të parashikuar me nenin 403 paragrafi 2 pika 1 e KPPK, të lexuar me nenin 400 paragrafet 1, 2 dhe 4 të KPPK si edhe me nenin 3 paragrafi 2 i KPK. Për këtë çështje avokatët mbrojtës ngritën dy çështje: nëse pala e dëmtuar është e detyruar të paralajmërojë ankesën, dhe cilat janë pasojat në qoftë se pala e dëmtuar nuk arrin të bëjë këtë.

Sipas pikëpamjes së mbrojtjes, qëllimi i ligjberësve ka qenë të sjellin rendin dhe sigurinë ligjore duke imponuar një detyrim për të paralajmëruar ankesë dhe prandaj paragrafet e nenit 400 të KPK janë me karakter imperativë dhe të qartë. Sa u përket kuqizimeve të përmendura në paragrafet 3 dhe 4, avokatët mbrojtës pretendojnë që ata të janë të karakterit të pastër teknik.

Më tej, ursyetimi në aktgjykimin e kundërshtuar është plotësisht i papranueshëm dhe arbitrar sepse gjykata e shkallës së dytë konsideroi se dështimi i palës së dëmtuar përfundimtar i paralajmëruar ankesë nuk e bën mjetin ligjor të papranueshëm. Paragrafi 4 i nenit 400 të KPPK do të zbatohej në lëndë dhe prandaj ankesa nuk kishte përfunduar. Ky interpretim i dispozitave ligjore nga kolegji i apelit është i dëmshëm përfundimtar. Më tej, paragrafi 4 "nuk e zgjidh çështjen e paralajmërimit të ankesës dhe çështjen e pasojave ligjore nëse personi, që ka të drejtën e ankesës, nuk e bën këtë."



Avokatët mbrojtës pohojnë se Gjykata e shkallës së dytë ka bërë shkelje të dispozitave të procedurës penale të parapara me nenin 403 paragrafit 2 pikën 1 në lidhje me nenin 3 paragrafit 2 të KPK-së lidhur me parimin *In dubio pro reo*.

Për më tepër, gjykata e shkallës së dytë ka hartuar të zbatojë dispozitat e nenit 417 të KPPK-së (*Reformation in peius*) dhe në këtë mënyrë ka bërë shkelje të procedurës penale sipas nenit 403 paragrafit 2 pikës 1 në lidhje me nenin 417 të KPPK-së.

Avokatët mbrojtës përfundimisht pretendojnë se gjykata e shkallës së dytë ka shkelur dispozitat e Kodit pasi që ankesa e Palës së dëmtuar është dashur të hedhet poshtë sipas nenit 407 paragrafit 2 të KPPK-së

#### *2. Shkelja substanciale e dispozitave ië procedurës penale ië përcaktuar me nenin 403 paragrafit 1 pikën 12 të KPPK-së*

Avokatët mbrojtës pohojnë se aktgjykim i përmban arsyet e fakteve përkatëse dhe se arsyetimi është "tërësisht i plogësht dhe për këtë arsy e paqartë dhe i pakuptueshëm" në lidhje me zbatimin e nenit 400 të KPPK-së.

#### *3. Shkelja e ligjit penal në lidhje me dënimin në kundërshtim të nenit 404 pikës 5 të KPPK-së*

Avokatët mbrojtës pretendojnë se gjykata e shkallës së dytë ka bërtë shkelje të ligjit penal pasi që i ka tejkluar autorizimet e veta sipas ligjit duke e pranuar ankesën e Palës së dëmtuar dhe duke e dënuar të Pandehurin me një dënim më të gjatë.


Përfundimisht, avokatët mbrojtës kanë paraqitur Plotësimin në Kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë më 7 korrik 2011. Avokatët mbrojtës i janë referuar lëndës së Radivoje Virijevic (Ap-Kž. Nr. 238/2010) ië Gjykatës Supreme të Kosovës. Në lëndën e përmendur, më 28 qershor 2011, Gjykata Supreme ka marrë qëndrim se ankesa e Palës së dëmtuar nuk ka qenë e pranueshme sepse nuk ishte paralajmëruar më parë.

#### *4. Përgjigje në kërkesën e të pandehurit për mbrojtjen e ligjshmërisë*

Në përgjigjen e saj, ZPSHÇ-ja i propozon Gjykatës Supreme që ta refuzojë kërkesën e të pandehurit për mbrojtjen e ligjshmërisë.

ZPSHÇ-ja pajtohet me aktgjykimin e shkallës së dytë në lidhje me leximin e kombinuar të nenit 400 paragrafëve 1, 2 dhe 4 të KPPK-së. Ajo parashton se nuk duhet të bëhet asnjë paralajmërim në rastin e burgimit dhe se paragrafi 4 i nenit 400 përmes paragrafit 2, ofron një përashtim për afatin kohor nën paragrafin 1 të këtij nenit.

Për më tepër, ZPSHÇ-ja pohon se asnjë paralajmërim i ankesës nuk ka qenë i nevojsbëm në këtë lëndë, nuk ka pasur shkelje të nenit 3 paragrafit 2 të KPK-së. Më tutje, parimi *Reformation in Peius* nuk ka qenë i zbatueshëm në këtë rast pasi që ankesa e Palës së dëmtuar është paraqitur në dërm të Pandehurit.



ZPSHk-ja pohon se dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së dytë është i qartë dhe në përputhje me ursyemin e aktgjykimit.

Sipas mendimit të ZPSHk-së, gjykata e shkallës së dytë ka qenë në pozitë që ta rriss dënimin e shqiptuar pa i tejkaluar autorizimet e saj pasi që ankesa e paraqitur nga pala e dëmtuar ka qenë e pranueshme.

Përfundimisht, ZPSHk-ja e adreson çështjen e dënit. Pas shqyrtimit të aktgjykimit të shkallës së dytë, ZPSHk-ja beson se rrethanat lehtësuese të lëndës nuk i përmashesh kushtet e nenit 66 paragrafit 2 të KPK-së për të shqiptuar dënim nën limitin e përcaktuar me ligj.

### *III. Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës*

#### *1. Kompetencat e Gjykatës Supreme të Kosovës dhe Prauveshmëria e Kërkesës përmbrojtjen e ligjshmërisë*

Gjykata Supreme e Kosovës është kompetente që të vendosë lidhur me kërkessat përmbrojtjen e ligjshmërisë sipas nenit 454 dhe 26 paragrafit 3 të KPK-së. Kolegji i Gjykatës Supreme është formuar në pajtim me nenin 3 paragrafin 7 të Ligjit nr. 03/L-053 mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë.

Kërkesa përmbrojtjen e ligjshmërisë është e pranueshme. Kërkesa është paraqitur me kohë pranë gjykatës kompetente sipas neneve 452 paragrafit 3 dhe 453 të KPK-së.

#### *2. Procedura pranë Gjykatës Supreme të Kosovës*

Gjykata Supreme e Kosovës ka vendosur mbi kërkesën përmbrojtjen e ligjshmërisë në seancë siç parashihet me nenin 454 paragrafin 1 të KPK-së. Kolegji i Gjykatës Supreme ka mbajtur këshillimet më 12 dhe 19 korrik dhe më 23 gusht 2011. Palët nuk janë njoftuar përmes seancat.

#### *3. Meritat e kërkesës përmbrojtjen e ligjshmërisë*

*Shkelja substanciale e dispozitave të procedurës penale të përcaktuara me nenin 403 paragrafin 2 pikën 1 të KPK-së në lidhje me nenin 400 paragrafët 1, 2 dhe 4 dhe nenin 404 pikën 5 të KPK-së*

Avokatët mbrojtës theksojnë se nenit 400 i KPK-së në lidhje me paralajmërimin e ankesës brenda tetë (8) ditëve. Është dispozitë e karakterit obligativ dhe kufizuar e përmendura në paragrafët 3 dhe 4 janë të karakterit të pastër teknik. Prandaj, gjykata e shkallës së dytë ka bërë shkëlje të dispozitave të procedurës penale, përkatesisht hedot



403 paragrafit 2 pikës I të KPPK-së në lidhje me nenin 3 paragrafin 2 të KPK-së. Gjykata e Apelit gjithashtu ka haruar të zbatojë dispozitat e nenit 417 të KPPK-së. Rrjetimisht, ankesa e palës së dëmtuar është dashur të hedhet poshtë sipas nenit 407 paragrafit 2 të KPPK-së.

ZPShK-ja pohon se asnjë paralajmërim nuk duhet të bëhet në rastet e burgimit dhe se paragrafi 4 i nenit 400 është përjashtim i afatit kohor nën paragrafin 1.

Rregullat e aplikueshme në procedurën e ankesës përcaktojnë se personat me të drejtë ankesë duhet ta paralajmërojnë ankesën e tyre. Formulimi i paragrafit 1 të nenit 400 të KPPK-së e bën paralajmërimin e ankesës të natyrës obligative, siç është cekur me të drejtë nga avokati mbrojtës. Për më tepër, afati prej "jo më vonë se tetë ditë pas datës së shpalljes së aktgjykit" është i përcaktuar. Qëllimi i ligjvënësit ka qenë që të ofrohet siguria relative dhe ekonomizimi i procedurës penale në raste të caktuara.

Gjykata Supreme pranon se kushti për paralajmërimin e ankesës duket paksa i pazakontë në krahasim me sistemet e tjera të drejtësisë. Personat me të drejtë në ankesë duhet ta paralajmërojnë ankesën kundër një aktgjyki i cili as nuk është lëshuar e as nuk është dorëzuar akoma. Nën paragrafin 2 mos paralajmërimi i ankesës konsiderohet si heqje dorë nga e drejta për ankesë. Gjendet një përjashtim në paragrafin 4: edhe në rast të mos paralajmërimi të ankesës, aktgjyki i shkruar duhet të përfshijë arsyetimin dhe duhet bërë transkribimin e audioincizimit të shqyrtimit gjyqësor.

Gjykata Supreme vëren se gjatë procedurës së shkallës së parë, pas shpalljes së aktgjykit kryetari i trupit gjykuar në mënyrë të qartë i ka udhëzuar palët lidhur me obligimin e paralajmërimit të ankesës brenda 8 ditëve nga shpallja e këtij aktgjykimi.<sup>1</sup> Palët e dëmtuara kanë marrë pjesë në seancë. Avokati mbrojtës L. [REDAKTUE] P. [REDAKTUE] ka paralajmëruar ankesën e tij me shkrim më 26 nëntor 2009.

Në aktgjykin e datës 4 maj 2010, Gjykata e Apelit gjeti se ankesa e palës së dëmtuar është e pranueshme, edhe pse nuk është e paralajmëruar brenda afatit kohor të caktuar me ligji. Kolegji i ankesave konsideroi se "Neni 400 Paragrafi 2 i KPPK-së thotë se kur personi me të drejtë ankesë nuk e paralajmëron ankesën brenda afatit të paraparë ligjor, konsiderohet se ai ka hequr dorë nga e drejta në ankesë, përvëç në rastin nga paragrafi 4 i Nenit 400. Paragrafi 4 i kësaj dispozite i referohet lëndëve ku i akuzuar është dënuar me burgim." Gjykata e shkallës së dytë përfundoi se marrë parasysh se i akuzuar ka qenë i dënuar me gjashtë (6) vjet e tre (3) muaj burgim, Paragrafi 4 i Nenit 400 të KPPK-së ujen zbatim dhe si rezultat ankesa nuk kishte nevojë të paralajmërohet.<sup>2</sup>

Në kërkësen e tyre, Avokatët mbrojtës i referohen lëndës Radivoje Virijević (Ap-Kž. Nr. 238/2010) të Gjykatës Supreme të Kosovës të datës 28 qershor 2011, në të cilën Gjykata Supreme hodhi poshtë ankesën e palës së dëmtuar pasi që ankesa nuk ishte paralajmëruar. Në këtë lëndë, kolegji përfundon se përjashtimi i Nenit 400 Paragrafit 4 të KPPK-së është

<sup>1</sup> Gjykata e Qarkut në Mitrovicë. Prosesverbal i shqyrtimit gjyqësor P. Nr. 134 08, 19 nëntor 2009. <sup>2</sup> Gjykata Supreme e Kosovës. Aktgjyki Ap - Kž. Nr. 24/2010, i datës 4 maj 2010. L. [REDAKTUE], V. [REDAKTUE]. Gjaliën Angleze.



i zbatueshëm vetëm ndaj të pandehurit dhe kësijoj pala e dëmtuar ka hequr dorë nga e ulreja për ankesë sipas paragrafit 2 të kësaj dispozite.

Ky kolegji pranon se dispozitat e Nenit 400 të KPPK-së mund t'i nënshtronën sqarimeve. Është shqetësues hutimi pasi që ka mospërputhje në mes versioneve të nenit 400 në gjuhën angleze dhe në gjuhën shqipe. Gjersa paragrafi 4, në versionin e gjuhës angleze, thotë "[n]ëse i akuzuari dënohet me burgim dhe nuk është paralajmëruar ankesë", versioni i gjuhës shqipe thotë "dhe i akuzuari nuk paralajmëron ankesë".


Gjykata Supreme mbrojtëse versioni autentik i Kodit, ai në gjuhën angleze, mbizotëron. Ky version nuk specifikon se cili person ka të drejtë të paralajmërojë. Mungesa e specifikimit të ligjit duhet të interpretohet në atë mënyrë që të sigurojë një trajtim të drejtë të palëve në procedurë. Pa marrë parasysh shkrimin çorientues dhe mospërshqatjen e përkthimit, paragrafi 4 duhet të zbatohet si përfashtim i përgjithshëm i obligimit për paralajmërimin e ankesës në dobi të të gjithë personave me të drejtë ankesë, jo vetëm të të pandehurit. Nëse i akuzuari dënohet me burgim, nuk ka nevojë të paralajmërohet ankesë dhe mos paralajmërimi i ankesës nuk e përfashton mundësinë e paraqitjes së ankesës. Ankesë e tillë e paraqitur nga personi me të drejtë ankesë duhet të shpallet e pranueshme përvèç nëse përcaktohet ndryshe me ligj. Zbatimi i paragrafit 2 mbi heqjen dorë nga e drejtë për ankesë mohohet nga paragrafi 4 i KPPK-së, siç përshkruhet qartë në ligj. Ky interpretim vërtetohet me anë të jurisprudencës së vazhdueshme të Gjykatës Supreme të Kosovës.<sup>4</sup> Mbrojtja gabimisht konteston se nuk ekziston lidhje në mes paragrafëve 1 dhe 2 dhe paragrafëve 3 dhe 4 të Nenit 400.

Në lëndën në fjalë, i pandehuri është dënuar me burgim dhe pala e dëmtuar nuk ka paralajmëruar ankesë. Përfashtimi i përcaktuar me Paragrafin 4 të Nenit 400 të KPPK-së në këtë rast është i zbatueshëm. Prandaj Gjykata e shkallës së dytë drejt ka shpallur ankesën e palës së dëmtuar të pranueshme.

Lidhur me parashtresën e mbrojtjes përkitazi me zbatimin e parimit *In dubio pro reo*, kolegji i Gjykatës Supreme dëshiron të qartësojë se Neni 3 paragrafi 2 i KPPK-së është i zbatueshëm vetëm në rast të mëdyshjes lidhur me ekzistimin e faktave përkatëse përlëndën ose lidhur me implementimin e një dispozite të caktuar të ligjit penal. Kjo nuk ka të bëjë tanë me këtë lëndë pasi që ka të bëjë me interpretimin e ligjit të procedurës. Gjykata Supreme e Kosovës nuk gjen shkelje të Nenit 403 Paragrafit 2 Pikës 1 lidhur me Nenin 400 Paragrafët 1, 2 dhe 4 të KPPK-së. Si rezultat i kësaj, Gjykata Supreme e Kosovës nuk ka nevojë të vendosë mbi parashtresa shtesë të Mbrojtjes përkitazi me

<sup>1</sup> Neni 400 Paragrafi 4 i KPPK-së, versioni shqip: "(4) Kur i akuzuari dënohet me burgim dhe nuk paralajmëron ankesë, aktigjikimi i shkruar duhet të përfshijë arsyetimin dhe duhet bërë transkribimin e audioincizionit."

<sup>2</sup> Shih *inter alia* Gjykata Supreme e Kosovës, Aktvendimi Ap. Nr. 3/2011, 13 korrik 2011: në këtë lëndë kolegji i ankesave refuzoi ankesën e prokurorit Publik si të papranueshme në përputhje me nepjoli <sup>122.16</sup> KPPK-së sepse sipas nenit 400 paragrafi 1 të KPPK-së, personat me të drejtë ankesë përfshijnë paralajmërujnë ankesën. Në lëndën në fjalë Prokurori Publik i Qarkut nuk paralajmëroi ankesën dha nën 400) paragrafi 4 i KPPK-së nuk zbatohet pasi që është shqiptuar dënimini me kusht: shih po ashtu *Cod Rati* Supreme e Kosovës, Aktvendimi Ap. Nr. 9/2010, 8 korrik 2011.



shkeljet e pretenduara të Nenit 403 Paragratit 2 Pikës 1 lidhur me Nenin 417 të KPPK-së (*Reformation in peius*) dhe Nenit 407 Paragratit 2 të KPPK-së.

*Shkeljet substancialë të dispozitave të procedurës penale të përcaktuar nga Neni 403 Parografi 1 pika 12 e KPPK-së*

Avokatët mbrojtës pohojnë se "vendimi nuk përmban madje as arsyetimit apo faktet përkatëse" dhe se arsyetimit i mungon qartësia. ZPSHK pohon se dispozitivi i aktgjykit të shkallës së dytë është i qartë dhe i pajtueshëm me bazat e aktgjykit.

Përkitazi me këtë Gjykata Supreme nuk gjen asnjë mungesë të arsyetimit apo qartësisë në dispozitiv ose në thelb të aktgjykit të kundërshtuar. Vendimi përmban një pjesë lidhur me Gjetjet e Gjykatës Supreme që përfshin një arsyetim të qartë dhe të kuptueshëm mbi se cilën bazë të ankesës. Prandaj Gjykata Supreme gjen se ky argument është i pabazuar.


*Shkelja e ligjit penal sa i përket dënimit në kundërshtim me Neni 404 Pikën 5 të KPPK-së*

Avokatët mbrojtës pretendojnë se Gjykata Supreme ka bërë shkelje të ligjit penal pasi pranoi ankesën e palës së dëmtuar, dhe, pas vendosjes mbi këtë ankesë, e dënoi të pandehurin me një dënim më të rëndë.

ZPSHK u përgjigj se Gjykata e shkallës së dytë ishte në gjendje ta rriste dënimin e shqiptuar pa tejkaluar kompetencat e veta pasi që ankesa e paraqitur nga pala e dëmtuar ishte e pranueshme. ZPSHK po ashtu pohon se rrethanat lehtësuese të lëndës nuk i plotësojnë kushtet nga Neni 66 Parografi 2 i KPK-së për shqiptimin e dënitit nën kufirin e përcaktuar me ligj.

Sa i përket dënimit, Gjykata e shkallës së dytë gjeti se dënim i shkallës së parë i shqiptuar kundër të pandehurit për vepër penale të Vrasjes së rëndë në tentativë (pika B) ishte shumë i butë. Kolegji për ankesa i morri parasysh të gjitha rrethanat rënduese (faktin se plumbi ende është në trupin e viktimës dhe ka pak gjasa të hiqet) dhe lehtësuese (peshën e veçantë të gjendjes mendore të të akuzuarit; pa dosje të mëparshme penale të të akuzuarit) siç janë shënuar në aktgjykim. Sipas pikëpamjes së kolegjit për ankesa "madje as kombinimi i këtyre tre faktorëve nuk është aq i jashtëzakonshëm sa të plotësohen kushtet nga Neni 66 paragrafi 2 i KPK-së". Gjykata e shkallës së dytë caktoi dënimin nga minimumi i mundshëm i dënitit prej dhjetë (10) vjet deri në tridhjetë (30) vjet burgim, në përputhje me Nenin 65 Paragrin 2 të KPK-së. Gjykata e Ankesave prandaj shqiptoi një dënim me dyshëdhjetë (12) vjet burgim për pikën B.

Gjykata e Ankesave procedoi me vlerësimin e rrethanave të lëndës dhe ushtroi një rishikim gjyqësor të vendimit të shkallës së parë mbi dënimin. Shkalla e dytë përfundoi se dispozitat e Nenit 66 dhe 67 nuk ishin të zbatueshme. Kolegji për ankesa nuk ka tejkaluar kompetencat e veta duke aplikuar një diapazon të dënitit të mundshëm që është 15 vjet. Neni 147 i KPK-së të zbutur në përputhje me Nenin 65 Paragrin 2 të KPK-së.



Prandaj është vendosur sikur në dispozitiv.

**Kryetari i Kolegit**  
Lars Dahlstedt  
Gjyqtar i EULEX-it

**Anëtarët e Kolegit**

---

Marije Ademi  
Gjyqtare e Gjykatës Supreme

---

Francesco Florit  
Gjyqtar i EULEX-it

---

Emine Mustafa  
Gjyqtare e Gjykatës Supreme  
  
Republika Kosovo

